



REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

**KUVENDI KOMUNAL OBILIQ**

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly of Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), bazuar në nenin 25, të Ligjit nr.08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, bazuar në Rregulloren nr.01/2025 për mekanizmin koordinues lokal për mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, bazuar në nenin 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës nr.-I-34, të dt.25.04.2016, si dhe nenin 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, nr.-I-95, të dt.29.06.2018, Kuvendi i Komunes pas shqyrtimit të kërkesës nr. 02-104-02-3829-26 të dt.09.02.2026 nga Njësi Antidiskriminim dhe Barazi Gjinore në mbledhjen e mbajtur me dt.27.02.2026 mori këtë:

**V E N D I M**

1. Bëhet plotësim ndryshimi i vendimit nr.01-060-01-17633-25 të dt.01.07.2025 për Themelimin e Mekanizmit Lokal Koordinues për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në bazë Gjinore me këtë përbërje:
  - 1.1. Halil Thaqi, Kryetar
  - 1.2. Albertina Dedinca, DSHMS
  - 1.3. Edita Çanta, Gjykata Themelore Prishtinë
  - 1.4. Arlind Popaj, Prokuroria
  - 1.5. Mema Mjeku, ZMNY – Prokuroria
  - 1.6. Reijan Ibrahim, BIK-Obiliq
  - 1.7. Mexhid Krasniqi, QPS
  - 1.8. Adlije Seta, Policija e Kosovës
  - 1.9. Zana Asllani, Strehimorja – QMGF
  - 1.10. Fatime Pllana, DKA
  - 1.11. Vjollca Hoti, QKMF
  - 1.12. Slavisa Adjancic, ZLK
  - 1.13. Faton Jashari, Ndihma Juridike Falas A.N.J.F.
  - 1.14. Emine Berisha, Zyra e punësimit
  - 1.15. Ganimete Aliu, Njësia antidiskriminim dhe barazi gjinore
  - 1.16. Zelushë Kelmendi, Qendra Rinore

2. Melanizmi Koordinues Lokal korrndinon aktivitetet për parandalimin, mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të të gjitha formave të dhunës pa diskriminim në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë ose lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetsësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë bazë tjetër me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.
3. Ky mekanizëm Lokal Koordinues do të kryej detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me Ligjin nr.08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, në pajtim me aktin nënligjor të propozuar nga Ministria e drejtësisë në bashkëpunim me MAPL-në dhe të miratuar nga Qeveria.
4. Ky Vendim hyn në fuqi (30) tridhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL-së si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunes.

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesuesit
- Anëtarëve të KK
- Zyres Antidiskr.dhe Barazi Gjinore
- MAPL
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunes

*Sami Ahmeti*  
Sami Ahmeti